Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
Data: 26.08.20 Vendi Kaçanik
Numri Shtojcë
01-370/01-207991/20

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

# KONTRATA PËR FURNIZIME

**KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë të cilen e përfaqson Shefket Koxha, Menaxher i Prokurimit; dhe

***N.P.SH "Elioni.Com" nga Gllogovc*** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga **Gentrit Bajraktari i autorizuar me ID-1231839611** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

**Furnizim me inventar për nevojat e shkollave.** me numër Identifikues **652-20-4042-1-3-6**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me inventar për nevojat e shkollave.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me ***26.08.2020* dhe përfundon me *05.08.2020.***

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *dy (2)* ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i do të jetë Zyra e pranimit te Adm. komunale-*Kaçanik*

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP[1] (Detyra e Dërguar e Paguar).

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **7,461.00€; (Shtatëmijëekaterqindegjashtdhjetenji euro.)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

---

[1] DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

**Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e detyrimeve pas pranimit të furnizimeve nga ana e personit të autorizuar-zyrtarit të pranimit.
[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për, pas pranimit të *[furnizimeve]*

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

**Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

**Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [*Shqip*][2] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Operatorin Ekonomik** **Për Autoritetin Kontraktues**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | Gentrit Bajraktari | **Emri:** | Shefket Koxha |
| Pozita: | I autorizuar | Pozita: | Menaxher i Prokurimit |
| Nënshkrimi: | [signature] | Nënshkrimi: | [signature] |
| Data: | 26.08.2020 | Data: | 26.08.20 |
| **Vula:** | [stamp: ELIONI COM, Gllogoc] | **Vula:** | [stamp: Republika e Kosovës, Komuna e Kaçanikut] |

---

[2] Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

ELIONI COM

| Paramasa dhe parallogari për furnizim me inventar për Shkolla | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| NR | PERSHKRIMI | NJESIA MATESE | SASIA | QMIMI PER NJESI | TOTALI | DETAJE |
| 1 | Tavolina per nxenes me dimensione 130*50*76 cm, konstrukti te jete nga materiali I hel :rit 2.5*2.5 cm*1.8mm , kurse pjesa mbajtese dhe sanaku per mbajtjen e librave nga materiali I druti te plastifikuar. | c | 80 | 27,5 | 2200 |  |
| 2 | Furnizimi dhe transporti I karrigeve standarte për nxënës te shkollave filiore, konstrukti te jete nga materiali I hekurit 2.5*2.5cm*1.5mm kurse pjesa e uleses dhe mbeshtetesja te jene nga materiali I drutrit | c | 160 | 12,5 | 2000 |  |
| 3 | Furnizimi dhe transporti I tavolinave për mësimdhënës me konstrukt nga materiali i hekurit me dim.25x25x1.8, kurse pjesa mbajtese materiali I drurit te plastifikuar me dimensione 70x140, pjesa ballore dhe anesoret te jene te mbeshtjellura nga nga marteriali I drurit, në llogari të hyjnë edhe sanaku me 3(tre) sitare e montuar në pjesën e mbrendshme të tavolinës. | c | 9 | 35 | 315 |  |
| 4 | Furnizimi dhe transporti I karrigeve standarte për arsimtarë, konstrukti i karrigeve te jet nga materiali i hekurit kurse pjesa e uleses dhe mbeshtetesja nga materiali i drurit i mveshur me singer dhe shtof. | c | 10 | 18 | 180 |  |
| 5 | Tabela të zeza për klase me dimensione 2.40*1.20 cmne llogari te hyn edhe montimi i tyre ne objekte shkollore. | m' | 10 | 60 | 600 | |
| 6 | Varrese për rroba nga materiali I hekurit | c | 15 | 15 | 225 | |
| 7 | Karrige per salle te mesimdhenesve me konstrukt nga materiali I hekurit kurse psesa e uleses dhe mbeshteteses te jete nga materiali I drurit te mveshura me singer 5 cm dhe shtof. | c | 12 | 15 | 180 |  |
| 8 | Tavolinë për sallë të arsimtarëve, konstrukti nga materiali I hekurit kurse pjesa e e rrafshet mbajtese nga materili I drurit te plastifikuar me dimensione 3.20*1.40 cm | c | 1 | 130 | 130 | |
| 9 | Tavolinë për sallë të arsimtarëve,per vendosjen e paisjeve ,konstrukti te jete nga materiali I drurit te plastifikuar me dimensione 2.90*0.60cm dhe larteria 0 90 cm, kurse pjesa e poshtme te jete me rafta dhe me dyer me mundesi mbyllje me qeles. | c | 1 | 150 | 150 | |
| 10 | Rafta për vendosjen e ditarëve për sallë te arsimtareve nga materiali I drurit te plastifikuar me dimensione 3m gjeresia dhe 2m lasteri, 3m*2m*0.50cm,pjesa e poshtme te jete me rafta dhe me dyer me mundesi mbyllje me qeles dmth 1m*3m kurse pjesa e eperme 3m*1m me dy rena doliape per vendosjen e ditareve me hapsire 4 deri 5cm. | c | 1 | 120 | 120 | |
| 11 | Orman nga materiali I drurit te plastifikuar me me 24 kaseta me dyer me mundesi mbollje me qeles per arsimtar me dimensione ballorja te jete 0.40*0.60 thellesia 0.50cm per kasete | c | 1 | 225 | 225 | |
| 12 | Tabela per njoftime me dimnesione 1m*1m me r aterial per mundesin e vendosjes se njoftimeve dhe te kete ramin dhe dyert nga materiali I plastikes me xham te tejdukshem per paje, mbyllja me qeles e cila duhet te vendoset ne hapsirat e jashtme te objektit. | c | 1 | 20 | 20 | |
| 13 | Tavoline per zyren e drejtorit me rreth, nga materiali I drurit te plastifikuar me dimensione 160x80x76, 80x100x76, kendi 80x80x76 dhe sirtari 3F, anesoret pllake zdrukthi iverplaka , d= 25mm , me shirit ABS d=2mm. | c | 1 | 180 | 180 |  |
| 14 | Karrige levizese per zyre te drejtorit , me mundesi ulje- ngritje, rregullim shpine, e meveshur me lekure ose shtof kualitativ. komponentet te jene te atestuara me ajeste perkatese | c | 1 | 40 | 40 |  |
| 15 | Ulese Taburet ne forme katrore me dimensione 0.45*0.45 cm ne forme klatrore me konstrukt nga materiali I drurit dhe e mveshur me singer 5cm dhe shtof ose lekure me ngjyra te ndryshme. | c | 8 | 7 | 56 | |
| 16 | Ulese Taburet ne forme rrethore me dimension perimetri 1m*0.45* cm ne forme kubi me konstrukt nga materiali I drurit dhe e mveshur me singer 5cm dhe shtof ose lekure me ngjyra te ndryshme. | c | 8 | 30 | 240 | |
| 17 | Ulese Taburet ne forme kubi me dimensione 1.30*0.45 cm ne forme rrethore me konstrukt nga materiali i drurit dhe e mveshur me singer 5cm dhe shtof ose lekure me ngjyra te ndryshme. | c | 10 | 40 | 400 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | Tavoline per uise taburet nga materiali I drurit te plastifikuar me dimensione 1.20*0.60 *0.35cm me ngjyra te ndryshme. | c | 4 | 25 | 100 | |
| 19 | Tavoline per uise taburet nga materiali I drurit te plastifikuar me dimensione 1.20*0.35 cm ne forme rrethore me ngjyra te ndryshme. | c | 4 | 25 | 100 | |
| 20 | | | | | 0 | |
| 21 | | | | | 0 | |
| | Totali | | | | 7461 | |